



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2024 për shoqëritë ujësjellës kanalizime, të cilat furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 202.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shkurt 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “Furra buke dhe/ose prodhim mielli”.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023.
6. Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare.
7. Mbi lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, i shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)”.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
9. Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 240, datë 03.08.2023 dhe refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për Hec-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k..
10. Mbi kërkesën e shoqërisë “Truen” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.

12. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.253, datë 23.08.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20MW (AC).
13. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.303, datë 23.10.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”.
14. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar.
15. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.97, datë 09.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit-Karavasta,Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140MWp.